



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.6042019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.09.2019 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alstezo” sha nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me REF-19850-04-26-2019 me objekt Loti III: *Blerje vajra lubrifikant, alkool frenash dhe pastrues motori*”, fond limit 66,633,207.95 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.05.2019 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** “Alstezo” sha  
Lagjia “Kryengritja e Fierit”, Rruga Aulona, Fier
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 26.04.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me REF-19850-04-26-2019 me objekt Loti III: *Blerje vajra lubrifikant, alkool frenash dhe pastrues motori*”, fond limit 66,633,207.95 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.05.2019 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 29.05.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 14.06.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Kadiu	35,922	I skualifikuar
- Eximoil	57,995,823	I skualifikuar
- Top Oil	37,800	I kualifikuar
- Alstezo	42,360	I skualifikuar
- Kappa Oil	35,360	I skualifikuar

II.4. Në datën 14.06.2019 operatori ekonomik “Alstezo” sha është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*1- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 6, në pikën 7 dhe në pikën 9 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9 të DT-së, pasi: - nuk arriti të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi për të gjithë artikujt e përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së dhe të deklaruar si prodhues në dokumentin e emërtuar “lista e vajrave që shoqëron katalogët teknik”. a) Nga verifikimi i dokumentave të hedhura si pjesë e ofertës së tij rezultoi se ofertuesi ka paraqitur autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga “WOLFOIL CORPORATION” S.A të datës 27.05.2019, për të gjithë artikujt e përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së por nuk rezultoi të ketë paraqitur autorizim nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, “ADINNOL”, “CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX”, të deklaruar si të tillë në dokumentin e emërtuar “lista e vajrave që shoqëron katalogët teknik” për artikujt me numrat rendor: 4;5;10; 13; 14; 18; 32; 33; 48; 50; 56; 59; 60; 61; 62; 63; 64; 65; 66; 67 dhe 70, referuar sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) të DT. b) Në autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga “WOLFOIL CORPORATION” S.A të datës 27.05.2019, evidentohen të 72 artikujt e kërkuar, po në katalogun shoqërues të këtij prodhuesi nuk janë të pasqyruara të dhënat teknike dhe specifikimet teknike për artikujt me numrat rendor: 13;18; 32; 33; 48; 50; 56; 59; 60; 61; 62; 63; 64; 65; 66; 67 dhe 70, referuar sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) të DT.*

*- Nuk arriti të paraqesë raport analizë për artikullin: Vaj për kuti shpejtësie, “ATF G 052 162 /G 060 162”, Dexron VI ose ekuivalent me nr rendor 43 ne Tabelen e Përgjithshme te Vajrave ne Shtojcen 10. OE rezultoi të ketë paraqitur raport analizimi për : Dextron III.*

*- Nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga OE, për këtë procedurë prokurimi, rezultoi se mostrat e artikujve :Vaj motori për automjete, “SAE 5Ë-40 me nr rendor 10; Vaj motori për automjete, “SAE 15Ë-40”, me nr rendor 22; Vaj motori për automjete, “SAE 20Ë-50”, me nr rendor 28 në Tabelën e Përgjithshme të Vajrave në Shtojcën 12, nuk kanë tapa sigurie të dyfishta, kerkesë e përcaktuar në në pikën 9 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9 të DT-së.*

II.5. Në datën 19.06.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit argumentojmë si vijon: Në shtojcën 9 Loti III, pika 2 Kriteret e vecanta të kualifikimit kërkohet midis të tjerash :
6. *Operatori ekonomik duhet te provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
  7. *Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë/ broshurë të vajra lubrifikant,alkool frenash dhe pastrues motorri**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura duhet te markohen (per lehtësi identifikimi) artikujt vajra lubrifikant,alkool frenash dhe pastrues motorri dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 10 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të vajra lubrifikant,alkool frenash dhe pastrues motorri sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) ku të specifikohen të dhënat si vijon:*

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi i artikullit (gomës)</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Emërtimi kompanisë prodhuese</i>	<i>Emërtimi i katalogut</i>	<i>Numri i faqes në katalog</i>	<i>Part-Number i prodhuesit</i>	<i>Standarti i Cilësisë</i>
------------	--------------------------------------	---------------	--------------	-------------------------------------	-----------------------------	---------------------------------	---------------------------------	-----------------------------

*Sa më sipër në lidhje me pikën 2.3/6 në plotësim të saj kemi paraqitur Autorizimin e prodhuesit lëshuar nga WolfOil Corporation” me datë 27.05.2019 pikërisht për këtë procedurë prokurimi. Në këtë autorizim janë të evidentuara shumë qartë të dhënat e pota të prodhuesit si: telefon, mail, ëbsite kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.*

*Sa i përket kërkesës së AK në lidhje me pikën 2.3.7 në plotësim të saj ne kemi paraqitur : katalogë/broshurë të vajra lubrifikantë, alkol frenash dhe pastrues motorri ku janë përfshirë spcifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/broshura kemi markuar (për lehtësi identifikimi) artikujt vajra lubrifikant, alkol frenash dhe pastrues motori dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në shtojcën 10 të DST.*

Kemi paraqitur tabelën shoqëruese për katalogët/broshurat me një listë të vajrave lubrifikant , alkol frenash dhe pastrues motorri sipas tabelës së përgjithshme ku janë specifikuar të dhënat si vijon:

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi i artikullit (gomës)</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Emërtimi kompanisë prodhuese</i>	<i>Emërtimi i katalogut</i>	<i>Numri i faqes në katalog</i>	<i>Part-Number i prodhuesit</i>	<i>Standarti i Cilësisë</i>
------------	--------------------------------------	---------------	--------------	-------------------------------------	-----------------------------	---------------------------------	---------------------------------	-----------------------------

Sa më sipër pretendimi i AK lidhur me këtë pikë nuk qëndron.

- Lidhur me pretendimin e AK Nuk arriti të paraqesë raport analizë për artikullin: Vaj për kuti shpejtësie, "ATF G 052 162 /G 060 162", Dexron VI ose ekuivalent me nr rendor 43 ne Tabelen e Pergjithshme te Vajrave ne Shtojcen 10. OE rezulton të ketë paraqitur raport analizimi për : Dextron III (referuar kodit origjinal të kërkuar ne nr 43), argumentojmë si vijon: Në shtojcën 10 nga ana e AK për këtë artikull kërkohet përkatësisht si vijon:

43	Vaj për kuti shpejtësie		ATF G 052 162 /G 060 162	Kutia e shpejtësisë automatike	Dexron VI ose ekuivalent
----	-------------------------	--	--------------------------	--------------------------------	--------------------------

Lidhur me këtë kërkesë të vendosur nga AK , në plotësim të këtij kriteri ne si OE në përcaktimin e llojit të vajit i jemi referuar kodit origjinal të kërkuar nga ana juaj i cili është unik dhe i patjetërsueshëm. Theksojmë se teknikisht nëpërmjet këtij kodi shprehet në mënyrë të përcaktuar niveli i specifikimit për lubrifikantin që ju kërkon, ndërkohë që Dexron është familja e përgjithshme e mërtimit të llojit të produktit të vajit. Nga ana e AK është kërkuar në tabelë për nr.43 me numër origjinal –parts number-ID të përcaktuar e cila në vetvete është e dhëna e vetme teknike që përcakton drejt dhe në mënyrë unike llojin e vajit të kërkuar nga ana e AK në DT. Ndërkohë paradoks është edhe miratimi i këtij fakti që vetë AK konfirmon OE rezulton të ketë paraqitur raport analizimi për : Dextron III (referuar kodit origjinal të kërkuar ne nr 43). Nuk e kuptojmë këtë qëndrim të AK , pra ku qëndron mnagësia në dokumentacionin tonë si OE për plotësimin e kërkesës të vendosur vetë nga AK në plotësimin e këtij kriteri??

Sa më sipër nxjerrim edhe konkluzionin tjetër shumë të rëndësishëm si vijon: Ndërkohë që ne i jemi përmbajtur me rigorozitet të kërkesave të bëra nga AK për këtë pikë do të thotë që konkurruesit e tjerë të klasifikuar sipas KVO nuk kanë paraqitur llojin e lubrifikantit që përputhet me kodin origjinal part number, ATF G 052 162/G, 060 162 (në rastin konkret lubrifikantit me nr.43) të kërkuar nga AK. Më këtë mënyrë insitojmë se duhet të rishikohet vlerësimi i bërë nga KVO për këta opertorë ekonomikë lidhur me plotësimin e kërkesës të vendosur nga AK.

*Sa më sipër pretendimi i AK lidhur me këtë pikë nuk qëndron.*

- *Lidhur me pretendimin e AK Nga verifikimi i mostrave të paraqitura nga OE, për këtë procedurë prokurimi, rezultoi se mostrat e artikujve :Vaj motori për automjete, “SAE 5Ë-40 me nr rendor 10; Vaj motori për automjete, “SAE 15Ë-40”, me nr rendor 22; Vaj motori për automjete, “SAE 20Ë-50”, me nr rendor 28 në Tabelën e Përgjithshme të Vajrave në Shtojcën 12, nuk kanë tapa sigurie të dyfishta, kerkesë e percaktuar në në pikën 9 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9 të DT-së.*

*Në shtojcën nr.1 lidhur me DST është kërkuar si më poshtë: Mostrat duhet të jenë ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara dhe te paraqitura ne oferten teknike, duhet te jene me ambalazhim fabrike, me etikete fabrike ku te jene te pasqyrara specifikimet teknike, me tape sigurie te dyfishte dhe detyrimisht të jenë të volusora me vulën e ofertuesit dhe të nënshkruara në vende të dallueshme si dhe te jetë percaktuar nr. rendor korrespondues me Tabelen e Pergjithshme te Vajrave ne Shtojcën 12.*

*Lidhur me këtë pretendim të AK së pari theksojmë se dorëzimi i mostrave nuk është bërë në përputhje me rregullat e prokurimit publik pasi:*

- *Mostrat nuk u morrën në dorëzim me specifikimet e tyre përkatësisht për cdo lloj të dorëzuar pra nuk u shkrua asnjë e dhënë tjetër vecse një numër që shpreh gjendjen numerike në kohën e dorëzimit dhe asnjë lloj informacioni tjetër për cdo rast në vecanti sa i përket llojit të vajit të dorëzuar si mostër, emrit të mostrës , numrin e mostrës (part number) , apo ndonjë të dhënë specifike për cdo rast. Ky fenomen duket edhe në procesverbalin e marrjes së mostrave në dorëzim përpiluar nga KVO.*
- *Dorëzimi i mostrave nuk u bë transparent në sy të të gjithë OE pjesmarrës, por thjesht u numëruan një për një (në prezencë të cdo operatori në vecanti për mostrat e paraqitura përkatësisht) pa u parë në detaje dhe pasqyruar në P.verbal qoftë edhe sa i takon aparencës , numër reference përkatës për cdo mostër në vecanti apo të dhënave teknike të kërkuara në DT. Përfaqësuesit e OE pjesmarrës thjesht u thirën të gjithë së bashku në zyrën e prokurimeve sa për të parë pjesmarrjen dhe për tu njoftuar lidhur me rezultatin e cmimit/njësi dhe asgjë tjetër e vecantë lidhur me mostrat e dorëzuara.*
- *Së fundi sa i përket tapës së sigurisë theksojmë se cdo tapë me të cilën janë mbyllur bidonat e vajit të paraqitura nga ana jonë përkatësisht mbart në vetvete të gjithë elementët e sigurisë qofshin këto të dyfishta dhe jo vetëm, theksojmë se cdo mall i dorëzuar nga ana jonë është i certifikuar dhe brend normave ndërkombëtare të sigurisë CE edhe pse s i përket nivelit të sigurisë , vlen të theksohet fakti që produkti që ne po ofrojmë nuk është i nivelit të enëve nën presion sikurse janë gazi apo avulli etj.*

*Kompania WolfOil Corporation nv është një kompani e certifikuar sa i përket sistemit të menaxhimit të cilësisë së produktit sipas kërkesave të EN ISO 9001:2015 Sistem i Menaxhimit të Cilësisë për objektin në fjalë.*

*Dorëzimi i mostrave nga ana jonë u bë në prezencë të administratorit të shoqërisë i cili edhe pse nguli këmbë për identifikimin e cdo lloji vaji të dorëzuar si mostër kjo nuk u morr në konsideratë nga ana e përfaqësuesve të KVO , për të cilët rëndësi kishte vetëm fakti i dorëzimit si sasi numerike në momentin e dorëzimit të tyre, duke mos evidentuar asnjë të dhënë tjetër lidhur me kodet e mostrave të dorëzuara gjë që u provua edhe me shënimet e plotësimit të procesverbalit të mbajtur hartuar nga ana e KVO. Mostrat tona ne i dorëzuam të etiketuara, të vulosura me vulën Alstezo sha dhe të nënshkruara në vende të dallueshme me nr rendor korenspondues me tabelën e përgjithshme të vajrave në shtojcën 12.*

*Sa më sipër këkrojmë të bëhet edhe njëherë vlerësimi i mostrave të paraiqtura nga OE pjesmarrës për të bërë atë më transparente dhe konform rregullave të përcaktuara në LPP.*

*Përfundimisht kërkohet rivlerësim të ofertave të OE pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi si dhe riklasifikim nga KVO. Pasi të rishikohet edhe njëherë dokumentacioni i tyre të bëhet klasifikimi i ofertës tonë si ofertë që i ka plotësuar të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në kushtet e vecanta të kualifikimit pika 2.3/6 dhe 2.3/7 për këtë objekt prokurimi si dhe shtojcës nr.1 të DST.*

II.6. Me shkresën nr.1112/1 prot datë 26.06.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 05.07.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.1278/1 prot datë 16.07.2019 protokolluar me tonën me nr.1210/2 prot datë 18.07.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” sha mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “ 1- Ofertuesi nuk plotëson

kriterin e përcaktuar në pikën 6, në pikën 7 dhe në pikën 9 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 9 të DT-së, pasi: - nuk arriti të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi për të gjithë artikujt e përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së dhe të deklaruar si prodhues në dokumentin e emërtuar “lista e vajrave që shoqëron katalogët teknik”. a) Nga verifikimi i dokumentave të hedhura si pjesë e ofertës së tij rezulton se ofertuesi ka paraqitur autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga “WOLFOIL CORPORATION” S.A të datës 27.05.2019, për të gjithë artikujt e përfshirë në tabelën e përgjithshme (shtojca 12) e DT-së por nuk rezulton të ketë paraqitur autorizim nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, ”ADINNOL”, ”CHAMPION”, ”RAVENOL”, ”CASTROL”, ”MOTUOL”, ”CYCLO” dhe ”CHIMITEX”, të deklaruar si të tillë në dokumentin e emërtuar “lista e vajrave që shoqëron katalogët teknik” për artikujt me numrat rendor: 4;5;10; 13; 14; 18; 32; 33; 48; 50; 56; 59; 60; 61; 62; 63; 64; 65; 66; 67 dhe 70, referuar sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) të DT. b) Në autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga “WOLFOIL CORPORATION” S.A të datës 27.05.2019, evidentohen të 72 artikujt e kërkuar, po në katalogun shoqërues të këtij prodhuesi nuk janë të pasqyruara të dhënat teknike dhe specifikimet teknike për artikujt me numrat rendor: 13;18; 32; 33; 48; 50; 56; 59; 60; 61; 62; 63; 64; 65; 66; 67 dhe 70, referuar sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) të DT”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3/6 dhe 2.3/7 ”Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

- Operatori ekonomik duhet te provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.
- Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/ broshurë të vajra lubrifikant,alkool frenash dhe pastrues motorri, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura duhet te markohen (per lehtësi identifikimi) artikujt vajra lubrifikant,alkool frenash dhe pastrues motorri dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 10 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të vajra lubrifikant,alkool frenash dhe pastrues motorri sipas tabelës së përgjithshme (shtojca 12) ku të specifikohen të dhënat si vijon:

Nr.	Emertimi i artikullit (gomës)	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Numri i faqes në katalog	Part-Number i prodhuesit	Standarti i Cilësisë



III.1.2. Në shtojcën 12 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit”, të dokumentave të procedurës së prokurimit object ankimi përcaltohet si më poshtë:

<b>Loti III. “Blerje vajra lubrifikant, alkool frenash dhe pastrues motori”</b>							
<b>Marreveshje Kuadër 24 muaj</b>							
<b>Tabela e Përgjithshme</b>							
<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>LLOJI</b>	<b>APLIKIMI</b>	<b>Specifikimi teknik i mallit</b>		<b>Njësia</b>	<b>SASIA TOTALE</b>
				<b>Duhet të përmbajë një nga specifikimet teknike te unifikuara)</b>	<b>Duhet të përmbajë një nga specifikimet teknike te unifikuara)</b>		
1	Vaj motori sintetik për automjete	SAE 0Ë-30	Motori i automjeteve	SN, SM, SL, SJ, SN PLUS	ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5	Litër	251
2	Vaj motori për automjete	SEA 5Ë-30	Motori i automjeteve	API SJ	ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5	Litër	450
3	Vaj motori për automjete	SEA 5Ë-30	Motori i automjeteve	API SL	ACEA A3/B3, A3/B4, A5/B5 ose C1, C2, C3, C4, C5	Litër	499
4	Vaj motori për automjete	SEA 5Ë-30	Motori i automjeteve	API SM	ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5	Litër	221
5	Vaj motori për automjete	SEA 5Ë-30	Motori i automjeteve	API SN	ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5	Litër	900
6	Vaj motori për automjete	SEA 5Ë-30	Motori i automjeteve	API CH-4	ACEA E4, E6, E7 ose E9	Litër	251
7	Vaj motori për	SEA 5Ë-30	Motori i automjeteve	API CI-4	ACEA E4, E6, E7 ose	Litër	1950

	<i>automjete</i>				<i>E9</i>		
8	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SEA 5Ë-30</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API CJ-4</i>	<i>ACEA E4, E6, E7, E9, ose C1, C2, C3, C4, C5</i>	<i>Litër</i>	<i>1030</i>
9	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 5Ë-40</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SJ</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</i>	<i>Litër</i>	<i>1410</i>
10	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 5Ë-40</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SL</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</i>	<i>Litër</i>	<i>150</i>
11	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 5Ë-40</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SM</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</i>	<i>Litër</i>	<i>220</i>
12	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 5Ë-40</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SN</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4, A5/B5 ose C1, C2, C3, C4, C5</i>	<i>Litër</i>	<i>800</i>
13	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 5Ë-40</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API CH-4</i>	<i>ACEA E4, E6, E7 ose E9</i>	<i>Litër</i>	<i>230</i>
14	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 10Ë-40</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SJ</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</i>	<i>Litër</i>	<i>7480</i>
15	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 10Ë-40</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SL</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</i>	<i>Litër</i>	<i>300</i>
16	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 10Ë-40</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SM</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</i>	<i>Litër</i>	<i>4000</i>
17	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 10Ë-40</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SN</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4, A5/B5 ose</i>	<i>Litër</i>	<i>200</i>

					C1, C2, C3, C4, C5		
18	Vaj motori për automjete	SAE 10Ë-40	Motori i automjeteve	API CH-4	ACEA E4, E6, E7 ose E9	Litër	110
19	Vaj motori për automjete	SAE 10Ë-40	Motori i automjeteve	API CI-4	ACEA E4, E6, E7 ose E9	Litër	2700
20	Vaj motori për automjete	SAE 10Ë-60	Motori i automjeteve	API SN	ACEA A3/B3, A3/B4, A5/B5 ose C1, C2, C3, C4, C5	Litër	4500
21	Vaj motori për automjete	SAE 15Ë-40	Motori i automjeteve	API SJ	ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5	Litër	4950
22	Vaj motori për automjete	SAE 15Ë-40	Motori i automjeteve	API SL	ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5	Litër	25
23	Vaj motori për automjete	SAE 15Ë-40	Motori i automjeteve	API SM	ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5	Litër	25
24	Vaj motori për automjete	SAE 15Ë-40	Motori i automjeteve	API SN	ACEA A3/B3, A3/B4, A5/B5 ose C1, C2, C3, C4, C5	Litër	200
25	Vaj motori për automjete	SAE 15Ë-40	Motori i automjeteve	API CH-4	ACEA E4, E6, E7 ose E9	Litër	715
26	Vaj motori për automjete	SAE 15Ë-50	Motori i automjeteve	API SN	ACEA A3/B3, A3/B4, A5/B5 ose C1, C2, C3, C4, C5	Litër	80
27	Vaj motori për	SAE 20Ë-50	Motori i automjeteve	API SJ	ACEA A3/B3,	Litër	400

	<i>automjete</i>				<i>A3/B4 ose A5/B5</i>		
28	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 20Ë-50</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SL</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</i>	<i>Litër</i>	<i>40</i>
29	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 20Ë-50</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SM</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</i>	<i>Litër</i>	<i>7000</i>
30	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>SAE 30</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API SN, SM, SL ose SJ</i>	<i>ACEA A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</i>	<i>Litër</i>	<i>800</i>
31	<i>Vaj motori për motoçikleta</i>	<i>2T</i>	<i>Motori 2 kohësh i motoçikletave</i>	<i>API TC</i>	<i>JASO FB, FC ose FD</i>	<i>Litër</i>	<i>50</i>
32	<i>Vaj motori për motoçikleta</i>	<i>5Ë-30 4T</i>	<i>Motori 4 kohësh i motoçikletave</i>	<i>API SN, SM, SL ose SJ</i>	<i>JASO MA 2</i>	<i>Litër</i>	<i>55</i>
33	<i>Vaj motori për motoçikleta</i>	<i>10Ë-30 4T</i>	<i>Motori 4 kohësh i motoçikletave</i>	<i>API SN, SM, SL ose SJ</i>	<i>JASO MA 2</i>	<i>Litër</i>	<i>40</i>
34	<i>Vaj motori për motoçikleta</i>	<i>15Ë-50 4T</i>	<i>Motori 4 kohësh i motoçikletave</i>	<i>API SJ</i>	<i>JASO MA 2</i>	<i>Litër</i>	<i>150</i>
35	<i>Vaj motori për motoçikleta</i>	<i>10Ë-60 4T</i>	<i>Motori 4 kohësh i motoçikletave</i>	<i>API SN, SM, SL ose SJ</i>	<i>JASO MA 2</i>	<i>Litër</i>	<i>40</i>
36	<i>Vaj për kuti shpejtësie</i>	<i>SAE 75Ë-90</i>	<i>Kutia e shpejtësisë manuale</i>	<i>API GL-5</i>		<i>Litër</i>	<i>50</i>
37	<i>Vaj për kuti shpejtësie</i>	<i>SAE 80Ë-90</i>	<i>Kutia e shpejtësisë manuale</i>	<i>API GL-4</i>	<i>MIL-L-2105</i>	<i>Litër</i>	<i>14</i>
38	<i>Vaj për kuti shpejtësie</i>	<i>SAE 85Ë-90</i>	<i>Kutia e shpejtësisë manuale</i>	<i>API GL-5</i>	<i>SAE J2360</i>	<i>Litër</i>	<i>100</i>
39	<i>Vaj për kuti shpejtësie</i>	<i>SAE 85Ë- 140</i>	<i>Kutia e shpejtësisë manuale</i>	<i>API GL-5</i>	<i>SAE J2360</i>	<i>Litër</i>	<i>20</i>

40	Vaj për kuti shpejtësie	SAE 90	Kutia e shpejtësisë manuale	API GL-1		Litër	700
41	Vaj për kuti shpejtësie	Vaji ATF II	Kutia e shpejtësisë automatike	Dexron IID ose ekuivalent		Litër	1450
42	Vaj për kuti shpejtësie	Vaji ATF 4+	Kutia e shpejtësisë automatike	Chrysler MS-9602 ose ekuivalent		Litër	100
43	Vaj për kuti shpejtësie	ATF G 052 162 /G 060 162	Kutia e shpejtësisë automatike	Dexron VI ose ekuivalent		Litër	20
44	Vaj për kuti shpejtësie	ATF III	Kutia e shpejtësisë automatike	Dexron III H ose ekuivalent		Litër	1710
45	Vaj hidraulik	HLP 68	Vaji Hidraulik ose Ekuivalent	DIN 51524 Part II ose ekuivalent		Litër	1215
46	Vaj hidraulik	HLP 46	Vaji Hidraulik ose Ekuivalent	DIN 51524 Part II ose ekuivalent		Litër	6000
47	Vaj hidraulik	SAE 10Ë	Vaji Hidraulik	CF, SF, GL-3		Litër	2000
48	Vaj motori për motoskafe	TC Ë-3	Motori dy kohësh i skafeve	NMMA TC-Ë3		Litër	25
49	Vaj kompresori	Vaj kompresori 100	Kompresorët me Pistona	DIN 51506-VDL ose ekuivalent		Litër	10
50	Vaj Armësh		Vaj Armësh	NATO CODE S-761,	S-758, MIL-PRF-63460E Amd.4	Litër	840
51	Vaj hidraulik	HVI 68	Vaji Hidraulik ose Ekuivalent	DIN 51524 Part II, Part III ose ekuivalent		Litër	200

52	Vaj Transmisioni	CLP-P220 (ose ekuivalent i tij)	Transmisioni	DIN 51517 Part III ose ekuivalent		Litër	55
53	Vaj hidraulik	Vaji Grup Timoni VË	Grupi timonit	G 004 000/G 002 012/G 052 146		Litër	69
54	Alkol Frenash	DOT-4	Sistemi frenimit	FMVSS 116, SAE J 1703	ISO 4925	Litër	770
55	Antifrizë motori	Antifrizë e përqendruar	(-40°C)	SAE J1034		Litër	10160
56	Antifrizë xhamash	Antifrizë xhamash	(-40°C)	Antifrize Xhamash(-40°C)		Litër	790
57	Graso litium	(LC-2) (ose ekuivalent i tij)	Litium Kompleks	NLGI-3		kg	10
58	Graso litium	(LC-2) (ose ekuivalent i tij)	Litium Kompleks	NLGI-2		kg	800
59	Pastrues Injektori	Pastrues Injektori Benzine	Depozita e karburantit			copë (min 200 ml)	48
60	Pastrues Injektori	Pastrues Injektori Naftë	depozita e karburantit			copë (min 200 ml)	86
61	Pastrues Karburatori	Sprait	Karburatori			copë (min 200 ml)	40
62	Pastrues Motori	Motor Flush	Në sipërfaqen e brendshme të motorit			copë (min 300 ml)	70
63	Solucion start ndezës	Sprait				copë (min 200 ml)	33
64	Solucion kontaktesh elektrike	Sprait	Kontaktet elektrike			copë (min 200 ml)	103

65	<i>Solucion për zhbllokim Radiatori</i>	<i>Solucion për zhbllokim dhe pastrim Radiatori</i>	<i>Radiator</i>			<i>copë (min 200 ml)</i>	90
66	<i>Pastrues i sistemit të gazrave</i>	<i>AdBlu</i>	<i>Katalit, SCR</i>	<i>DIN 70070 ose ekuivalent</i>	<i>ISO 2241-1</i>	<i>copë (min 200 ml)</i>	8400
67	<i>Pastrues i sistemit të gazrave</i>	<i>AdBlu</i>	<i>Katalit, SCR</i>	<i>DIN70070</i>	<i>ISO 2241-1</i>	<i>copë (min 200 ml)</i>	600
68	<i>Vaj motori për anije</i>	<i>SAE 15E40</i>	<i>Motorri i anijeve</i>	<i>API CI-4, CH-4, ACEA E7, E5, Global DHD-1, Cat ECF-2</i>	<i>API CI-4, CH-4, ACEA E7, E5, Global DHD-1, Cat ECF-2</i>	<i>Litër</i>	24500
69	<i>Vaj motori për anije</i>	<i>MIL 900H</i>	<i>Motorri i anijeve</i>	<i>TPEO 12 /SAE 40/ API CF</i>	<i>TPEO 12 /SAE 40/ API CF</i>	<i>Litër</i>	4314
70	<i>Vaj për anije</i>	<i>DS3-153</i>	<i>Linnjat e aksit</i>	<i>Marine 1230 API CF</i>	<i>Marine 1230 API CF</i>	<i>Litër</i>	1200
71	<i>Vaj motori për automjete</i>	<i>75/90</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API GL-5</i>		<i>Litër</i>	450
72	<i>Vaj motori sintetik për automjete</i>	<i>80/90</i>	<i>Motori i automjeteve</i>	<i>API GL-4</i>		<i>Litër</i>	1000

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimes "Alstezo" sha në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim Prodhuesi lëshuar nga Wolf Oil Corporation N.V për shoqërinë Alstezo shpk për artikujt 1-72 të procedurës së prokurimit objekt ankimi
- Katalogë nga Wolf Oil Corporation N.V
- Katalogë nga Addinol
- Katalogë nga Castrol
- Katalogë nga Ravenol
- Katalogë nga Cyclo
- Katalogë nga Chimitex

- Katalogë nga Motul
- Lista e vajrave që shoqërojnë katalogët teknike ku për disa nga produktet ankimesi ka deklaruar dy kompani prodhuese konkretisht Wolf Oil/Addinol dhe katalogë të Addinolit, Wolf Oil/Champion dhe katalogë të Champion, Wolf Oil/Ravenol-Katalogë Ravenol, Wolf Oil/Castrol –Katalogë Castrol, Wolf Oil/Motul –Katalogë Motul, Wolf Oil/Cyclo-Katalogë Cyclo, Wolf Oil/Chimitex-Katalogë Chimitex

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.4. Në nenin 27 pika 6 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se:

*Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*
- b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*
- c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.5. Referuar sa më lart, KPP pasi morri në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga ankimesi në përmbushje të kriterëve kualifikuese, konstaton se është paraqitur dokumenti autorizim prodhuesi lëshuar nga kompania prodhuese Wolf Oil Corporation N.V për të gjithë



artikujt objekt prokurimi. Ndërkohë janë paraqitur edhe katalogë të këtij prodhuesi ku pasqyrohen specifikimet teknike për një pjesë të konsiderueshme të artikujve objekt prokurimi.

Gjithashtu KPP vëren se ankimuesi ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentin me emërtim *"lista e vajrave që shoqëron katalogët teknike"* ku ka deklaruar si kompani prodhuese pervec "Wolf Oil" edhe prodhues të tjerë si ADINNOL", "CHAMPION", "RAVENOL", "CASTROL", "MOTUOL", "CYCLO" dhe "CHIMITEX" dhe katalogë të këtyre prodhuesve për disa nga artikujt objekt prokurimi e konkretisht për artikujt me nr rendor 4,5,10,13,14,18,32,33,48,50,56,60,61,62,63,64,65,66,67,70. Pra për disa nga artikujt janë deklaruar nga dy prodhuesedhe Wolf Oil dhe kompanitë e sipërcituara por kataloget për këto artikuj i perkasin vetëm kompanive ADINNOL", "CHAMPION", "RAVENOL", "CASTROL", "MOTUOL", "CYCLO" dhe "CHIMITEX".

Në këto kushte KPP gjykon se ankimuesi në rastin konkret duhet të kishte paraqitur dokumentacion i cili të provonte lidhjen midis prodhuesit Wolf Oil Corporation dhe prodhuesve të tjerë të deklaruar në dokumentin "Lista që shoqëron katalogët të tillë si "ADINNOL", "CHAMPION", "RAVENOL", "CASTROL", "MOTUOL", "CYCLO" dhe "CHIMITEX, ose në rast të kundërt duhet të provonte se disponon edhe nga këta prodhues autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi përderisa katalogët e paraqitur për një pjesë të produkteve objekt prokurimi sikundër ka deklaruar vetë ankimuesi u perkasin këtyre prodhuesve. KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL", "CHAMPION", "RAVENOL", "CASTROL", "MOTUOL", "CYCLO" dhe "CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre.

III.1.6. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vertetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të

konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vertetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Alstezo” shpik mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe operatori ekonomik ankimes nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera për operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurë, KPP sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimes edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*” me REF-19850-04-26-2019 me objekt Loti III: *Blerje vajra lubrifikant, alkool frenash dhe pastrues motori*”, fond limit 66,633,207.95 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 29.05.2019 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1210 Protokoli; Datë 05.07.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**